



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI**

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 19/08/2025 **Ora :** 12 :00

Vendi: Salla e Këshillit Bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 19 persona të pranishëm

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :

"Për miratimin e planit vendor të veprimit për barazinë gjinore 2025 – 2030 të
Bashkisë Pogradec"

Pjesëmarrës :

Manjola Kamolli (Kryetare e Këshillit)

Albana Prifti (Zv Kryetare e Këshillit)

Marjeta Biba (Këshilltare)

Vjollca Pllaha (Këshilltare)

Mimoza Shuli (Këshilltare)

Entela Gusho Zv Kryetare e Bashkisë

Ivana Llakmani Drejtore, Drejtoria e Shërbimeve Sociale

Manjola Kamolli (Kryetare e Këshillit) bëri një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- Projekt-aktin e propozuar dhe realcionin shoqërues.
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik.

- Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit.
- Jep informacion për adresat ku mund të dërgohen rekomandimet dhe afatin përkatës.
- Tregoi kalendarin e konsultimi publik dhe sqaroi procedurën si do të trajtohen rekomandimet.

Entela Gusho : Përshëndetje të gjithëve. Ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj në prezantimin e Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore. Ky është një plan shumë i rëndësishëm për të gjithë Bashkinë I cili ka filluar punën nga muaji Shkurt. Në planin e kaluar kemi plotësuar me sukses të gjitha objektivat dhe jemi një nga Bashkitë më të suksesshme në zhvillimin dhe aplikimin e Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore. Do të na ndihmonin dhe do ti vlerësonim shumë mendimet e juaja në lidhje me planin.

Manjola Kamolli: Të nderuara pjesëmarrëse, jemi mbledhur për të zhvilluar konsultimin public në bashkëpunim me Bashkinë dhe për të dëgjuar mendimet dhe sygjerimet e juaja. Barazia Gjinore nuk është vetëm një detyrim ligjor por një domosdoshmëri. . Dua të falenderoj gjithashtu grupin e punës për punën e palodhur.

Ivana Capollari: Po filloj me prezantimin shkurtimisht të planit.

Plani I Veprimit për Barazinë Gjinore është udhërrëfyese ynë për të ndërtuar një Pogradec ku gratë dhe burrat , vajzat dhe djemtë, kanë mundësi të barabarta në cdo fushë të jetës. Ky nuk është thjesht një dokument , por vullneti jonë politik për ta bërë barazinë gjinore një realitet të prekshëm për të gjithë. Plani është hartuar nga Bashkia Pogradec në përputhje me Strategjinë Kombëtare dhe kartën Europiane për barazi. Është një punë e përbashkët me mbështetjen e UN Women dhe Bashkimit European.

Vizioni ynë I përbashkët është një Pogradec ku të gjithë qytetarët , pavarësisht moshës, vendbanimit aftësive apo cdo karakteristike tjetër , gëzojnë respektojnë, dhe kontribuojnë për barazi gjinore reale në cdo aspekt të jetës.

Arbri Basho: Fushat ku do të përqëndrohemi pra 4 fushat kryesore të veprimit janë:

- 1-Fuqizimi Ekonomik dhe Social, që do të thotë më shumë mundësi punësimi dhe sipërmarrje për gratë dhe të rejtat.
- 2-Rritja e pjesëmarrjes në vendimarrje: Më shumë gra dhe të rinj në pozicione drejtuese në nivel vendor.
- 3- Një jetë e lirë nga dhuna: Parandalimi dhe lufta kundër dhunës me bazë gjinore dhe asaj në familje.

4-Barazia Gjinore në të gjitha politikat vendore: Integrimi I këndvështrimit gjinor në cdo plan, buxhet dhe shërbim të përbashkët.

Përsa I përket monitorimit e kemi menduar ta realizojmë nëpërmjet 4 pikave kryesore të cilat janë:

-Raportimi I Rregullt

-Monitorimi nga Këshilli Bashkiak

-Transparenca

-Rishikimi Vjetor.

Kjo ishte një përmbledhje shkurtimisht e Planit të Veprimit të Barazisë Gjinore. Mirëpresim mendimet dhe sygjerimet e juaja.

Albana Prifti: Dua të falenderoj grupin e punës për të gjithë punën e realizuar. Ne e dimë se çështja e barazisë gjinore është një çështje shumë e rëndësishme në shoqërinë tonë. Të gjitha aktivitetet e planifikuara mu dukën shumë interesante., gjithashtu dhe politikat për të nxitur gratë dhe vajzat.

Fjorela Xhindole: Ne bëjmë një plan në fillim të vitit për të gjitha aktivitetet që do të zhvillojmë.

Mimoza Shuli: Unë kam kënaqësi të bashkëpunoj me drejtorinë tuaj. E krahasoj me drejtoritë e tjera të qarkut të Korçës dhe për mua keni një vlerësim pasi bëni një punë që ju diferencon. Doja të thoja të filloni sa më shpejt në mënyrë që të përfitonin nga projektet.

Marjeta Biba: Unë doja të ndalesha pak te plani I aktiviteteve për shkollat. Do të ishte mirë që aktivitetet të prezantohen që në fillim të vitit për të koordinuar planet.

Shpresa Blacëri: Shohim që është një plan ambicioz, doja të sygjeroja më shumë vëmendje te gratë artizane gjithashtu fokusin ta vendosim te gratë si kryetare fshati.

Afroviti Gusho: Doja të përmendja disa pika kyce që mu dukën shumë të rëndësishme sic janë përfshirja e grave në zonat rurale, përfshirja e planeve në shkollat, dhe promovimi I grave në pozicione drejtuese në zonat rurale.

SEKRETARE E KËSHILLIT

Jona BOJKO

